



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 2706 prot

Tiranë, më 26 . 10 .2021

URDHËR

Nr. 119 , datë 26 . 10 .2021

PËR

**“PËRCAKTIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË DHE  
DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZONJË KANDIDATËT PËR ANËTAR TË  
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR” NË NIVEL NJËSIE KRYESORE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,  
TIRANË”**

Në bazë të nenit 3, 39, 46 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, 28, 29, 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Vendimit të Senatit Akademik nr. 78, datë 13.10.2021 “Për nisjen e procesit zgjedhor për komisionet e përhershme për dhënie e gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe miratimin e një ndër kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë , për të qenë anëtarë në këto komisione” të UMT-së,

URDHËROJ:

1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në UMT, janë si më poshtë:
  - a) Të jetë personel akademik me kohë të plotë në njësinë kryesore përkatëse në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
  - b) Të mbajë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.
  - c) Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal.
  - d) Të mos jetë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.
  - e) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
  - f) Të mos ketë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
  - g) Të mos jenë anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

2. Dokumentacioni që duhet të dorëzojë për aplikim kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në UMT, është si më poshtë:
  - a) Kopje e dokumentit të Identifikimit ID/ Pasaportë.
  - b) Kopje të njësuar me origjinalin të diplomës/dëshmisë së titullit akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” ose vërtetim të lëshuar nga UMT-ja në mungesë të diplomës/dëshmisë.
  - c) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.
  - d) Vetëdeklarim që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
  - e) Vetëdeklarim se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit..” i ndryshuar, dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
  - f) Vetëdeklarim që nuk është anëtar i Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.
3. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në strukturat përkatëse zgjedhore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas vendimit të tyre.
4. Ngarkohet Komisioni Institucional Zgjedhor dhe njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**REKTORI**  
**Prof. ARBEN GJATA**

